



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVETKOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMISIONI DISIPLINOR//DISCIPLINSKA KOMISIJA/ THE DISCIPLINARY COMMITTEE

KD.nr.9/2017

KOMISIONI DISIPLINOR, në përbërje nga gjyqtarët, Skender Çoçaj, kryetar, Armend Berisha dhe Gjimshir Galushi, anëtarë të Komisionit, në procedurën disiplinore ndaj Xxxx Xxxxx xxxxxx, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Xxxxxx, sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2016-387, në procedurën te Komisionit Disiplinor KGJK/KD/04/2017, për sjellje të pahijshme të përcaktuara sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2, dhe 1.4 shkelje e Kodit të Etikës sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në seancën e mbajtur në prezencën e përfaqësuesit të ZPD-së, Kadri Begolli, dhe Xxxx Xxxxx xxxxxx, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Xxxxxx, më datën 14.06.2017, në bazë të nenit 37 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, merr këtë:

V E N D I M

Xxxx Xxxxx xxxxxx, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Xxxxxx, **është** përgjegjëse për sjellje të pahijshme sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2016-387 i cili në procedurën te Komisioni Disiplinor ka marr numrin KGJK/KD/04/2017, sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2, dhe 1.4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Gjyqtares Xxxx Xxxxx xxxxxx, i shqiptohet masa disiplinore Qortim me udhëzim për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurorit Disiplinor ja ka paraqitur Komisionit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Raportin përfundimtar ZPD-2016-387 se bashku me shkresat e lëndës, më të cilin e ka ngarkuar Xxxx Xxxxx Xxxxxx, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Xxxxxx për sjellje të pahijshme të përcaktuara sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2- neglizhencë në kryerjen, dështim për të kryer apo abuzimin e funksioneve gjyqësore, dhe 1.4-shkelje e kodit të zbatueshëm të etikës të përcaktuara sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Hetimin disiplinor ZPD e kishte filluar në bazë të parashtresës së pranuar me shkrim nga Miftar Krasniqi nga Prishtina ku kishte theksuar se me datë 19 qershor 2015, Xxxxx Xxxxx Xxxxxx Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Xxxxxx (Gjykata) ka mbajtur seancën e fundit gjyqësore në lëndën C.nr.548/10.Kishin kaluar 15 muaj dhe gjyqtarja akoma nuk e kishte nxjerr vendimin me shkrim. Parashtruesi kishte theksuar se ka parashtruar kërkesë me shkrim,

të gjyqtarja dhe Kryetari i Gjykatës, për nxjerrjen e vendimit gjyqësor mirëpo vendimi gjyqësor akoma nuk e ka pranuar.

Pas zhvillimit të hetimit ZPD pretendon se ka siguruar prova të pa kontestueshme në mbështetje të këtij raporti përfundimtar, për të argumentuar se XxxX Xxxxx xxxxxx, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Xxxxxx, ka kryer sjellje të pahijshme. Provat që i ka siguruar ZPD gjatë hetimit disiplinor kanë rezultuar me gjetjen e sjelljes së pahijshme nga ana e gjyqtares për shkak se ajo në kundërshtim me dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, konkretisht neni 153 paragrafi 1 dhe 2 me një vonës të madhe mbi një vite ka përpiluar vendimin gjyqësor me shkrim në lëndën C.nr.548/10.

Në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 14.06.2017, përfaqësuesi i ZPD-së e ka mbështetur në tërësi raportin përfundimtar.

Gjyqtarja XxxX Xxxxx xxxxxx në seancë deklaroj se të gjitha ato që i tha prokurori disiplinor në seancë janë ashtu. Theksoj disa rrethana që kanë ndikuar deri te vonesa e hartimit të aktgjykimit, në atë kohë viti 2015 gjendja në Gjykatën Themelore në Xxxxxx ka qenë shumë keq sa i përket numrit të gjyqtareve. Në lëmin civile kanë qenë vetëm dy gjyqtar, përveç me lëndë civile që ka qenë e ngarkuar ka punuar edhe lëndë trashëgimore ku i ka pasur 253 lëndë, ka punuar edhe lëndë të ekzekutimeve dhe lëndë jashtë kontestimore. Mandej një gjyqtar kishte dalë në pension dhe gjyqtarja Xxxxx Xxxxx ishte ngarkuar me lëndë e tij, gjithsej 167 lëndë, një gjyqtar tjetër kishte ndërruar vendin e punës në vitin 2014 dhe gjithë lëndët e tij 189 ju kishin ngarkuar gjyqtares. Gjykata Themelore në Xxxxxx ju kishte drejtuar edhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës me kërkesë për shtimin e numrit të gjyqtarëve. E pranoj fajësinë time dhe se në atë periudhë nuk e kam vërejtur dhe nuk dua që ti iku përgjegjësia, përgjegjësia primare ka qenë e imja, sepse është dashur që ti klasifikoj lëndët dhe të ju jap prioritet atyre që janë me urgjencë, mirëpo përgjegjësia sekondare është edhe e Këshillit Gjyqësor të Kosovës i cili ka neglizhuar me gjykatën tone dhe ne kemi ardhur deri në atë situatë ku kemi punuar me një numër të madh të lëndëve dhe të llojeve të ndryshme.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i ZPD-së deklaroj se në rastin konkret kemi të bëjmë me atë që gjyqtarja e ka marrë në punë dhe e ka përfunduar lëndën dhe ka ngel pa e përfunduar vetëm hapin e fundit dhe se këtë ZPD e konsideron se ka sjellje të pahijshme. Kërkon nga Komisioni që provat janë të mjaftueshme ta aprovoj raportin dhe të merr vendim konform gjetjeve, pavarësisht kushteve objektive.

Gjyqtarja Xxxxx-Xxxxx në fjalën përfundimtare deklaroj se nuk ka se ka të shtoj më tepër për veç asaj që e kishte deklaruar me herët.

Pasi Gjyqtarja Xxxxx-Xxxxx i ka pranuar të gjitha shkeljet që janë paraqitur në raportin përfundimtar të ZPD-së, Komisioni nuk i ka administruar provat rreth kësaj çështje.

Nga të gjitha rrethanat e lartpërmendura komisioni gjeti se gjyqtarja XxxX Xxxxx xxxxxx është përgjegjëse për sjellje të pahijshme të një gjyqtari sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2, dhe 1.4 të

Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe shkelje të Kodit të Etikës për Sjellje Profesionale për Gjyqtar.

Për këtë sjellje të pahijshme të vërtetuar të gjyqtares Xxxx Xxxxx xxxxxx, Komisioni i shqiptoi masën disiplinore Qortim me udhëzim për ndërmarrjen e veprimeve .

Komisioni Disiplinor me këtë rast i rekomandon gjyqtare Xxxxx Xxxx qe ti ndjek trajnimet qe kanë të bëjnë me temën lidhur me menaxhimin e lëndëve.

Si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, Komisioni mori ngarkesën shumë të madhe me lëndë, mungesën e gjyqtarëve ne atë kohë në Gjykatën Themelore në Xxxxxx dhe e gjendur në një situatë të tillë i është dashur qe të merret me lëndë të llojeve të ndryshme, dhe shprehja e keqardhjes se pse ka ardhur deri te vonesa e hartimit të aktgjykimit konkret.

Në bazë të nenit 37 paragrafi 1 nën pikën 1.2 dhe paragrafit 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës u vendos si ne dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR
KD.nr.9/2017, date 14.06.2017

Kryetar i Komisionit Disiplinor
Gjyqtari, Skender Çoçaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në Prishtinë, brenda 15- ditësh nga dita e pranimt të Vendimit.

Vendimi u dërgohet;

- Nehat Idrizi, kryesues i KGJK-ës;
- Zef Prendrecaj, drejtor, Zyra e Prokurorit Disiplinor;
- Xxxxx Xxxxx, kryetar i Gjykatës së Themelore në Xxxxxx;
- Xxxx Xxxxx xxxxxx, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Xxxxxx;
- Administratës se Personelit në Sekretariatit e SKGJK-së;